

**VENDIM**  
**Nr. 637, datë 15.11.2023**

**PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME E ZONËS  
ARKEOLOGJIKE “A” TË GRADISHTËS SË SELCËS, BASHKIA POGRADEC,  
MIRATIMIN E ZONIMIT DHE PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE  
ADMINISTRIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 9, dhe të nënndarjes “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme e zonës arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës, Bashkia Pogradec.
  2. Miratimin e zonifikimit të zonës arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës, Bashkia Pogradec, sipas koordinatave dhe hartave në KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e kësaj zone, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  4. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi në hartat kadastrale, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
  5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e zonës arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës në Gjeoportalin Kombëtar.
  6. Vendimi nr. 788, datë 29.9.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës arkeologjike ‘A’ të Gradishtës së Selcës, rrethi i Pogradecit, dhe miratimin e rregullores së administrimit”, shfuqizohet.
  7. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZONËS  
ARKEOLOGJIKE “A” TË GRADISHTËS SË SELCËS, BASHKIA POGRADEC**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonës arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës, si dhe kufijtë e saj, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

**Neni 2**  
**Objekti**

Objekt i këtij plani është:

- a) ruajtja, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, arkeologjike dhe të peizazhit të zonës arkeologjike “A”;

- b) administrimi i zonës arkeologjike “A”;
- c) mënyra e bashkëpunimit të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të specializuara të ngarkuara për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të zonës arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës.

### Neni 3

#### **Hapësira arkeologjike në mbrojtje**

1. Hapësira në mbrojtje me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e Gradishtës së Selcës përbëhet nga zona arkeologjike “A”.

2. Kufijtë e zonës arkeologjike “A” paraqiten në hartën e zonifikimit të Gradishtës së Selcës, shoqëruar me koordinatat gjeografike në sistemin referues gjeodezik zyrtar – KRGJSH, pjesë përbërëse e këtij plani.

3. Plani i përgjithshëm vendor i Gradishtës së Selcës merr në konsideratë kufijtë e zonifikimit të zonës arkeologjike “A”, të Gradishtës së Selcës, si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj.

### Neni 4

#### **Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A”**

1. Në zonën arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës lejohen vetëm:

a) mirëmbajtja, restaurimi dhe konservimi i integruar i monumenteve të kulturës dhe strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KKTKM”);

b) kryerja e formave të testimit, të tilla si: sondazhe që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, hulumtime arkeologjike parandaluese dhe të shpëtimit, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore të miratuara nga struktura përgjegjëse për miratimin e projekteve kërkimore-shkencore pranë institucioneve shkencore, të përcaktuara në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja;

ç) rikonstrukcioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

d) vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 1 kat, në funksion të informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, trashëgiminë kulturore, si dhe nevojat e tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë vijon:

i. konstruksionet duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin;

ii. projekti për vendosjen e konstruksioneve të lehta miratohet nga KKTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen e strukturës;

iii. vendosja e tyre duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore të specializuara;

iv. kohëzgjatja e konstruksioneve duhet të jetë sezonale, jo më tepër se 1 (një) vit.

2. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A”, të Gradishtës së Selcës, të parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe më pas vijojnë procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

### Neni 5

#### **Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A”**

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës, projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 80, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton dhe vendos për kryerjen ose jo të formave të testimi. Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimi mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 4, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKTK).

4. Për ndërhyrjet e parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 4, përpara zbatimit të tyre, me miratim të KKTKM-së, nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike ose institucionet e specializuara shtetërore realizohen:

a) format e testimi sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 4, të mbikëqyrura nga institucionet shtetërore të specializuara;

b) monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara.

5. Për të gjitha ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A” realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike dhe/ose institucione shtetërore të specializuara dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

#### Neni 6

### **Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paautorizuara në zonën arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës**

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paautorizuara brenda zonës arkeologjike “A”, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për Gradishtën e Selcës, ka detyrimin të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit nëpërmjet aktit të konstatimit.

2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për Gradishtën e Selcës, njofton menjëherë Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Në rast se subjekti nuk ndërpret menjëherë veprimtarinë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për Gradishtën e Selcës, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, për marrjen e masave përkatëse në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

#### Neni 7

### **Gjetjet rastësore arkeologjike**

1. Klasifikohen si gjetje rastësore arkeologjike objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet e tyre arkeologjike dhe strukturat arkitektonike, sipas parashikimeve të nenit 144, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të punimeve në zonën arkeologjike “A”, punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 145, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

3. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për procedurën dhe hulumtimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e tyre.

4. Për çdo rast, veprimtaria arkeologjike realizohet sipas parashikimeve të neneve 139, 145, 146, 147, 260, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

#### Neni 8

### Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonën arkeologjike “A” lejohet vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja.

2. Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të konkurrojnë pamjen, peizazhin dhe integritetin e monumenteve, dëshmive dhe gjetjeve arkeologjike.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë pasurive kulturore dhe zonave mbrojtëse rreth tyre, dëshmive dhe gjetjeve arkeologjike bëhet në mbikëqyrjen e DRTK-së, përgjegjëse për qytetin e Pogradecit, pas lajmërimit zyrtar nga Bashkia Pogradec.

4. Tabelat e sinjalistikës rrugore/ turistike duhet të jenë në gjuhën shqipe, si dhe në një gjuhë me përhapje më të gjerë ndërkombëtare.

5. Është e ndaluar vendosja e posterave, si dhe dëmtimet e tjera (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme) të pasurive kulturore dhe rrënojave arkeologjike.

#### Neni 9

### Trajtimi i rasteve të paparashikuara

Të gjitha çështjet, që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore nëpërmjet institucioneve të specializuara.





## Gradishta e Selces - Zona Arkeologjike A

### Koordinata ne sistemin GRS 80

1	40°59'39.2000" N	20°31'07.0000" E
2	40°59'36.7000" N	20°31'03.5000" E
3	40°59'36.1000" N	20°31'00.6000" E
4	40°59'34.2000" N	20°30'59.9000" E
5	40°59'32.7000" N	20°31'00.0000" E
6	40°59'31.3000" N	20°31'00.1000" E
7	40°59'29.8000" N	20°31'00.1000" E
8	40°59'28.6000" N	20°31'01.0000" E
9	40°59'27.6000" N	20°31'02.5000" E
10	40°59'26.5000" N	20°31'02.7000" E
11	40°59'23.1000" N	20°31'01.0000" E
12	40°59'21.4000" N	20°31'01.9000" E
13	40°59'21.8000" N	20°31'03.7000" E
14	40°59'21.0000" N	20°31'05.5000" E
15	40°59'21.0000" N	20°31'08.0000" E
16	40°59'20.3000" N	20°31'10.2000" E
17	40°59'21.5000" N	20°31'13.1000" E
18	40°59'20.5000" N	20°31'14.5000" E
19	40°59'19.1000" N	20°31'14.9000" E
20	40°59'17.9000" N	20°31'14.9000" E
21	40°59'17.3000" N	20°31'15.7000" E
22	40°59'18.8000" N	20°31'18.4000" E
23	40°59'20.4000" N	20°31'18.6000" E
24	40°59'21.1000" N	20°31'17.8000" E
25	40°59'23.3000" N	20°31'18.6000" E
26	40°59'30.7000" N	20°31'18.4000" E
27	40°59'34.7000" N	20°31'14.5000" E
28	40°59'39.0000" N	20°31'07.7000" E
29	40°59'23.5000" N	20°31'21.4000" E
30	40°59'22.1000" N	20°31'20.6000" E
31	40°59'20.9000" N	20°31'21.8000" E
32	40°59'20.8000" N	20°31'24.3000" E
33	40°59'21.7000" N	20°31'25.1000" E
34	40°59'23.3000" N	20°31'24.8000" E
35	40°59'23.6000" N	20°31'24.4000" E

### Koordinata ne sistemin KRRGJSH

N 4540061.199297958	E 543637.3362354633
N 4539983.592877294	E 543555.9875891446
N 4539964.682401869	E 543488.3145267793
N 4539905.973552884	E 543472.2998659228
N 4539859.714710905	E 543474.9109388164
N 4539816.540716323	E 543477.5037893977
N 4539770.268053749	E 543477.7775173039
N 4539733.374398942	E 543499.0331880333
N 4539702.733547852	E 543534.2770569137
N 4539668.827957821	E 543539.152907425
N 4539563.70800791	E 543500.0373161122
N 4539511.390209405	E 543521.3850026162
N 4539523.97882382	E 543563.3865231286
N 4539499.549564862	E 543605.6075096971
N 4539499.896469559	E 543664.0446266728
N 4539478.608229269	E 543715.5977160451
N 4539516.02981104	E 543783.1644718966
N 4539485.376381166	E 543816.073077352
N 4539442.2443223875	E 543825.6805335003
N 4539405.226210977	E 543825.9012433181
N 4539386.828672921	E 543844.7117661554
N 4539433.478035524	E 543907.5484344815
N 4539482.863448132	E 543911.9285844794
N 4539504.345658549	E 543893.0997107794
N 4539572.323901867	E 543911.3941396687
N 4539800.574428098	E 543905.3555655711
N 4539923.424226776	E 543813.4617680087
N 4540055.126774442	E 543653.7340266176
N 4539578.884880705	E 543976.8061704247
N 4539535.585215714	E 543958.3647717997
N 4539498.734900916	E 543986.6359863399
N 4539495.99999143	E 544045.0916187398
N 4539523.875657669	E 544063.625078084
N 4539573.191118695	E 544056.3168037805
N 4539582.389613307	E 544046.9114950099